



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 tetor 2017
Nr. Ref.: RK 1141/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI100/16

Parashtrues

Živorad Dutina

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për Agjencinë Kosovare të Pronës, nr. GSK-KPA-A-97/2014, të 19 shkurtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Živorad Dutina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga Obiliqi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për Agjencinë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-97/2014 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), i 19 shkurtit 2016.
3. Aktgjykimi i lartpërmendur iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 29 mars 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të sipërpërmendur të Kolegjit të Apelit, me të cilin janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenit 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe nenit 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 korrik 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 16 gusht 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 5 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
9. Më 27 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili kishte dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës më 9 shtator 2016. Gjyqtari Altay Suroy u emërua kryesues i Kolegjit shqyrtues.
10. Më 4 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 22 maj 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), me ç'rast kërkoi riposelimin e parcelave 474 dhe 475 në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.43.44 m², dhe të vendosur në fshatin Milloshevë , Obiliq, në vendin e quajtur Vise Sela, të regjistruar me fletë poseduese nr. 75.
12. Më 11 qershor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), me Vendimin KPCC/D/A/204/2013, hodhi poshtë kërkesën pronësore për shkak të mungesës së juridiksionit.
13. Më 20 shkurt 2014, parashtruesi parashtrroi ankesë kundër vendimit në fjalë në Kolegjin e Apelit.
14. Më 19 shkurt 2016, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin GSK-KPA-A97/2014, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Vendimin e KKPK-së, të 11 qershorit 2013.
15. Në pjesën relevante të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, thuhet:

“... Në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, AKP-ja është kompetente që të zgjidhë kërkesat pronësore të cilat janë “drejtpërdrejt të lidhura apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”. Kjo do të thotë se korniza e vlerësimit të AKP-së është që të vërtetojë elementet në vijim: kush e ka poseduar pronën në kërkesën para 27 shkurtit 1998, kush e posedon pronën tani, kur dhe për çfarë arsye është humbur posedimi në mes të periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999. Nëse Komisioni konstaton se humbja e pronës kishte ndodhur para ose gjatë datës së mësipërme, apo në qoftë se humbja e posedimit nuk është e lidhur me konfliktin e armatosur, e njëjta e refuzon kërkesën pronësore sipas nenit 11.4 (b) të Ligjit Nr. 03 / L-079.

“...Pasi që kemi ardhur në përfundim se as ankuesi dhe as vëllezërit apo motra e tij nuk e kanë shfrytëzuar pronën në kërkesë pas vitit 1995, Gjykata Supreme konsideron se kërkesa pronësore bie jashtë juridiksionit të KKPK-së. Çështja nëse një kontratë e shitblerjes është lidhur me vëllanë e ankuesit në vitin 1995, mund të ketë efekt juridik është mjaft e parëndësishme për rezultatet e procedurës pranë kësaj Gjykate, pasi pretendimet e parashtruara nga vetë palët i përkasin kategorisë së mosmarrëveshjeve që duhet të zgjidhen nga gjykata civile kompetente. Vlerësimi i elementeve tjera që lidhen me blerjen e të drejtave pronësore bien jashtë juridiksionit të KKPK-së.

“...Rrjedhimisht, pasi që ankuesi nuk ka treguar se ai kishte posedimin e pronës në kërkesë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, se i njëjti kishte humbur posedimin gjatë konfliktit, Gjykata Supreme konsideron se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.
17. Parashtruesi ankohet për *“mungesën e një mekanizmi, ose mungesën e zbatimit të tij, me rastin e humbjes së pronës që nga qershori 1999, gjë që çoi në shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, siç thuhet në këtë parashtrësë. Parashtruesi gjithashtu ankohet sepse ai konsideron se autoritetet që kanë juridiksion nuk kanë vepruar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme në rastin e kërkesës së tij”*.
18. Ai në veçanti pretendon se Kolegji i Apelit vendosi në mënyrë të gabuar kur konstatoi se rasti i tij nuk është nën juridiksionin e AKP-së. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Kolegji i Apelit nuk i ka verifikuar provat e paraqitura në mënyrë të plotë dhe të ligjshme.
19. Ai deklaron *“Së pari, kërkesa e tij është hedhur poshtë me pretendimin se nuk është në kompetencë të AKP-së, sepse prona që nga paraluftra ishte jashtë posedimit të tij. Parashtruesi i kërkesës në procedurë gjyqësore ka dëshmuar se e ka gëzuar këtë pronë lirisht me bashkëpronarët tjerë deri në qershor të vitit 1999. Nuk është lidhur asnjë kontratë për tjetërsimin e pronës. Provat që i ka paraqitur pala e kundërt janë në kundërshtim me arsyen e shëndoshë dhe në mënyrë evidente janë falsifikuar. Gjykata nuk i ka shqyrtuar në mënyrë të vlefshme ligjore dhe të plotë pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Gjykata gjithashtu në procedurën e provave nuk e ka bërë verifikimin e nënshkrimeve dhe rrethanave tjera që kanë të bëjnë me kontratën që është bashkangjitur si provë kyçe”*.
20. Parashtruesi pretendon se e drejta e tij për vendim të arsyetuar ishte shkelur sepse *“aktgjykimet nuk përmbajnë qëndrime të arsyetuara për arsyet, për të cilat gjykatat nuk i kanë shqyrtuar provat e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës, dhe të cilat kanë qenë të rëndësishme në kuptim të parakushtit të garantimit të nxjerrjes së vendimit të drejtë. Në anën tjetër, ato tregojnë arbitraritet në vërtetimin e qëndrimit për mungesën e mundësisë së verifikimit të dokumentacionit dhe pabazueshmërisë së pamjaftueshme të qëndrimeve dhe vendimeve të tilla, dhe me këtë tregojnë arbitraritet”*.
21. Ai më tej konsideron se, *“...se ka ardhur deri te shkelja e të drejtës për qasje në gjykatë në atë mënyrë që në procedurën e kryer nuk ka ardhur deri te shqyrtimi i thelbit të shkeljes të së drejtës me pamundësinë e pretenduar të verifikimit të dokumentacionit të bashkëngjitur, por edhe të natyrës faktike dhe juridike të shfrytëzimit të pronës së kontestuar deri në qershor të vitit 1999”*.
22. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konteston *“interpretimin e Komisionit dhe të Gjykatës se patundshmëria kontestuese është tjetërsuar mjaft, përkatësisht e ka humbur posedimin para konfliktit 1998/99”*. Vetëm arsyetimi i vendimit

ankimor është dy kuptimor dhe i paqartë. Pikë së pari, nuk përmban arsye relevante, kriteret dhe prova të cilat ishin vendimtare dhe të vlefshme që të mund të konsiderohet se kontrata e pretenduar është e besueshme dhe se parashtruesi kishte humbur pronën në vitin 1995. Me këtë sjellje, Komisioni kishte vepruar në kundërshtim me obligimin ligjor të tij dhe parimit të drejtësisë, në aspektin se nuk ka shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme natyrën ligjore të kontratës së pretenduar dhe provat e parashtruesit që ai ka gëzuar pronën e tij deri në qershor të vitit 1999”.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh se: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

26. Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar. Përveç kësaj, kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatin e paraparë dhe parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

27. Gjykata, më tej, i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka sqaruar se cili akt i autoritetit publik kontestohet dhe cilat të drejta pretendohen se janë shkelur siç parashihet me nenin 48 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet gjithashtu të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka mbështetur pretendimet e tij siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

29. Prandaj, Gjykata më tej i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.”

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

30. Në bazë të shqyrtimeve të mësipërme përkitazi me kriteret e pranueshmërisë, Gjykata tani duhet të përcaktojë nëse kërkesa e parashtruesit është e arsyetuar *prima facie*; dhe nëse ai ka dëshmuar pretendimet e tij në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.
31. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se thelbi i kërkesës është se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me gjetjet e gjykatave lidhur me kohën kur ai ka humbur posedimin faktik të patundshmërisë së tij.
32. Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, *“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
33. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) konstatoi se *“është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale”*. *Shih: mutatis mutandis, rasti i GJEDNJ-së Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, 21 janar 1999, paragrafi 28.*
34. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i shqyrtoi në mënyrë të hollësishme provat dhe analizat e bëra nga KKPK-ja.
35. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit mori parasysh dhe i analizoi të gjitha pretendimet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij. Kolegji shpjegoi çështjen e juridiksionit të KKPK-së dhe barrën e të provuarit të vendosur në parashtruesin e kërkesës për të vërtetuar pretendimet e tij.
36. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
37. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë

pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu shih: *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

38. Kërkesa e parashtruesit nuk tregon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare ose të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih: rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
39. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.
40. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur dhe as nuk e ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, në veçanti për shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
41. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me kriteret e pranueshmërisë, rregulli 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullat 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 shtator 2017, njëzëri


VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi